



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 25.03.2019
Dokument parlamntar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.12/2018, “PËR
VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË
SË SHETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET
E BRENDSHME DHE ANKESAT, NË MINISTRINË E BRENDSHME”**

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 25.03.2019 në parim, nën për nen dhe në tërësi, projektligjin “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për çështjet e brendshme dhe ankesat, në Ministrinë e Brendshme”*”.

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm Ministri i Brendshëm Z.Sandër Lleshaj, Zëvendësministri i Brendshëm Z.Julian Hodaj, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Z.Ardi Veliaj dhe Drejtori i Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave Z.Muhamet Rrumbullaku.

Relator për shqyrtimin e projektligjit u caktua z.Pjerin Ndreu.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji është hartuar përputhje të neneve 78, 81, dhe 83, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, si dhe është në harmoni me legjislacionin në fuqi.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Skema e vlerësimit kalimtar të punonjësve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Brendshme, sipas ligjit ekzistues kryhet në tri faza, ku në çdo fazë vlerësohen afërsisht 300, 3 000 dhe 9 000 punonjës ndërsa numri i anëtarëve të komisioneve vlerësimit dhe sekretariateve teknike mbështetëse është parashikuar të jetë 30, 90 dhe 270.

Kjo skemë ka disa avantazhe pasi garanton pavarësi, paanshmëri dhe pronësi të procesit të vlerësimit nga vetë strukturat dhe disa disavantazhe pasi kërkon impenjim domethënës të burimeve materiale (procesi i vlerësimit do të kushtojë rreth 300 milionë lekë ose rreth 3 milionë dollarë) dhe atyre njerëzore (plot 240 punonjës të nivelit të lartë dhe të mesëm duhet të shpërdahen nga detyrat e tyre funksionale dhe të kryejnë procesin e vlerësimit).

Në këto kushte, duke pasur parasysh se vetë elementi financiar ishte një nga arsyet që solli vonesa në implementimin e procesit, Ministria e Brendshme, pas një analize të thellë dhe shumëplanëshe propozon një mekanizëm të ri për vlerësimin, i cili mund të arrijë po të njëjtat objektivat por me më pak kosto për buxhetin e shtetit.

Konkretisht propozohen dy ndryshime thelbësore, pa prekur substancën e kriterëve të vlerësimit apo të procedurës që duhet ndjekur:

1. Propozohet që punonjësit e SHÇBA-së të kalojnë të gjithë vlerësimin në fazën e parë. Sot ligji në fuqi parashikon që vetëm Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendësdrejtori, drejtorët dhe shefat e sektorëve e kalonin vlerësimin në fazën e parë. Vlerësimi i fazës së parë kryhet nga një komision i jashtëm me 15 anëtarë, i asistuar nga një sekretariat teknik me po 15 anëtarë.
2. Propozohet që të jetë SHÇBA-ja ajo që do të kryejë vlerësimin e të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës në fazën e dytë dhe të tretë, pra punonjësit e nivelit të mesëm drejtues dhe të atyre të nivelit bazë.

Kjo zgjidhje ka disa avantazhe të dukshme.

Së pari, ka një impakt të ndjeshëm mbi buxhetin e parashikuar. Ngarkimi i SHÇBA-së me vlerësimin e punonjësve në fazën e dytë dhe të tretë, pra rreth 12 000 punonjës, i kursen buxhetit të shtetit rreth 260 milionë lekë, duke minimizuar kostot shtesë.

Së dyti, garanton të njëjtin të standard për të gjithë procesin. Duke pasur parasysh se vetë punonjësit e SHÇBA-së do t'i nënshtrohen të njëjtit proces në fazë të parë dhe i njëjti standard do të përcillet përgjatë gjithë procesit në fazat e tjera.

Së treti, garanton të njëjtën pavarësi dhe paanshmëri, sa kohë nuk ndryshojnë as kriteret as procedurat e vlerësimit.

Së katërti, shkurton kohën e vlerësimeve individuale, sa kohë një pjesë e madhe e informacioneve për punonjësit e Policisë apo Gardës gjenden në arkivat e vetë SHÇBA-

së si organi i ngarkuar me monitorimin e punës së tyre dhe në veçanti me aspektet e integritetit, pa harruar rolin e vetë SHÇBA-së në proceset e pajisjes me certifikatë sigurie.

Projektligji nuk cenon fazën e parë të vlerësimit. Në këtë fazë, Komisioni i Jashtëm do të vlerësojë punonjësit që mbajnë grada apo funksione të larta në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe të gjithë punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Ky projektligj përbëhet nga 10 nene.

Neni 1 parashikon një përkufizim të ri të termit “Organe të vlerësimit”, duke hequr nga ky përkufizim komisionin qendror dhe komisionin vendor, që ishin përgjegjës për fazën e dytë e të tretë, dhe duke futur në vend të tyre Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Hiqet, gjithashtu, koncepti i trupës së posaçme të vlerësimit, sa kohë ishte një koncept i lidhur me mekanizmin e parashikuar për fazën e dytë dhe të tretë. Në momentin që propozohet ndryshimi i organeve nuk ka më logjikë ekzistenca e këtyre trupave.

Neni 2, ndryshon nenin 5, të ligjit, dhe saktëson se organet e vlerësimit janë vetëm Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe SHÇBA-ja, duke saktësuar edhe mënyrën e organizimit të këtij komisioni, duke hequr referencat që i bëheshin komisioneve të fazës së dytë dhe të tretë.

Neni 3, ndryshon nenin 6, të ligjit, dhe saktëson dy ndryshimet thelbësore të argumentuara më sipër, pra kalimin në vlerësimin në fazë të parë të të gjithë punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si dhe ngarkimin e SHÇBA-së me vlerësimin e të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës, që do të kalojnë vlerësimin në fazën e dytë dhe të tretë.

Neni 4, ndryshon nenin 13, të ligjit, dhe vendos një afat kohor për funksionimin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit deri në përfundim të fazës së parë, pra vlerësimit të pozicioneve drejtuese të Policisë së Shtetit, gradave të larta të Gardës së Republikës, dhe të gjithë punonjësve të SHÇBA-së.

Neni 5 shfuqizon nenet 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23 të këtij ligji që rregullonin përzgjedhjen, organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe sekretariateve të fazës së dytë dhe të tretë.

Neni 6 ndryshon nenin 24, të ligjit, duke saktësuar organizimin përkatës vetëm për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, sa kohë propozohet ndryshimi i autoritetit përgjegjës për vlerësimin në fazën e dytë dhe të tretë.

Neni 7, ndryshon nenin 29, të ligjit, pasi me ndryshimin e autoritetit përgjegjës për vlerësimin në fazën e dytë dhe të tretë, nuk ekziston më nevoja që anëtarët e këtyre të kthehen në pozicionet e mëparshme.

Neni 8, propozon rregullime në gjithë tekstin e projektligjit.

Fjalët “... komisionet e vlerësimit ...” zëvendësohen me “Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit” dhe fjalët “... sekretariateve teknike ...” zëvendësohen me “... sekretariatit teknik pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit ...”.

Gjithashtu, propozohen ndryshime në pjesën e procedurës së vlerësimit për të saktësuar se SHÇBA-ja do të ketë të njëjtat kompetenca dhe do të ndjekë të njëjtën procedurë që ndjek Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.

Neni 9, shfuqizon nenin 68 të ligjit, duke eliminuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e procesit. Procesi filloi me gati 9 muaj vonesë dhe nuk mendohet se ky afat mund të respektohet.

Neni 10, parashikon hyrjen në fuqi të ligjit.

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë prerzantimit të projektligjit Ministri i Brendshëm Z.Lleshaj u shpreh se ky propozimi lidhet me nevojat e zbatueshmërisë së ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Problemi kryesor i identifikuar deri tani lidhet me realizimin, pra përfundimin e procesit të vettingut brenda një afati 2 vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, që përkon më marsin 2020.

Duke pasur parasysh se vetë elementi financiar ishte një nga arsyet që solli vonesa në implementimin e procesit si dhe duke marrë në konsideratë faktin se procesi i vlerësimit kërkon impenjim të burimeve materiale dhe atyre njerëzore nga vete strukturat e Ministrisë së Brendshme pasi plot 240 punonjës të nivelit të lartë dhe të mesëm duhet të shkëputen nga detyrat e tyre funksionale dhe të kryejnë procesin e vettingut, u konkludua se duhen të bëhen disa ndryshime:

Mandej z.Lleshaj u shpreh se ky mekanizëm i ri nuk cënon procesin, pra nuk prek substancën e kriterëve të vlerësimit apo të procedurës së ndjekur dhe synon të arrijë po të njëjtat objektiva, si pavarësinë, paanshmërinë dhe objektivitetin e procesit.

Ndryshimet kanë të bëjnë konkretisht me:

- Heqjen e limitit kohor të përcaktuar nga ligji në fuqi që është mars 2020;
- Propozohet që punonjësit e SHÇBA-së të kalojnë të gjithë vlerësimin në fazën e parë. Vlerësimi i fazës së parë kryhet nga një komision i jashtëm me 15 anëtarë, i asistuar nga një sekretariat teknik me po 15 anëtarë.
- Propozohet që të jetë SHÇBA-ja ajo që do të kryejë vlerësimin e të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës në fazën e dytë dhe të tretë, pra punonjësit e nivelit të mesëm drejtues dhe të atyre të nivelit bazë.

Relatori i projektligjit, Z.Ndreu, në fjalën e tij u shpreh pro këtyre ndryshimeve që lehtësojnë procesin pasi ky është një proces shumë delikat dhe sensitiv i cili duhet të ndiqet korrekt dhe pa presion.

Gjithashtu, Z.Ndreu propozoi edhe dy sugjerime, konkretisht:

- Heqjen Gardës së Republikës nga procesi i vlerësimit. Garda e Republikës është një shërbim statik, pa impakt publik që synon ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve dhe objekteve.
- Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave duhet të mbështesë punën e tij mbi informacione të vërteta duke shmangur subjektivizmin. Gjithashtu ai u shpreh se duhet të këtë një amnisti të informacionit të klasifikuar pasi ai nuk mund të mbahet më shumë se 3 muaj.

Mandej anëtarët e komisionit u shprehën dakort me projektligjin dhe vijuan diskutimet në çështjet që lidhen me përballimin nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave të procesit të vlerësimit, cila do ishte koha e mjaftueshme për përmbylljen e këtij procesi, masat e marra nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në rastet e largimit të trupave policore nga detyra pas procesit të vlerësimit etj.

- ***Riformulime nen për nen***

Komisioni për Sigurinë Komëtare bazuar në çështjet e parashtruara, pyetjet e anëtarëve të komisionit dhe përgjigjet e dhëna nga përfaqësuesit e ministrisë propozuese si dhe nga diskutimi nen për nen i projektligjit propozon riformulimet si më poshtë:

Neni 3 i projektligjit ndryshon dhe riformulohet si më poshtë:

Neni 3

1. Shkronja “b” e pikës 1, të nenit 6, ndryshohet si më poshtë:

b) komandant, zëvendëskomandat dhe kolonel në Gardën e Republikës;

2. Shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.”.

3. Pika 2, e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat vlerëson të gjithë punonjësit e tjerë të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës.”.

4. Pikat 3 dhe 4, të nenit 6, shfuqizohen

Neni 4 i projektligjit riformulohet si më poshtë:

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

13. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e procesit të vlerësimit për kategorinë përkatëse të punonjësve sipas nenit 6, të këtij ligji, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

- ***Përfundim***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

- ***Në aspektin ligjor***, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- ***Në aspektin procedural***, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Relator

Pjerin NDREU

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ